



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 10/01/22 Ref.: 22/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, dhe të Vendimit të KShC-së, nr. 3236/21D të datës 21.09.2021; Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 94-të, të mbajtur më 21 dhjetor 2021, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Fakultetit të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, Nr. 3461/21H datë 27.10.2021 për akreditim të programit të studimit:
- Eficiencia e Energjisë, Master Profesional, 60 ECTS (ri akreditim)
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m i

Fakultetit të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” ka parashtruar kërkesë (Nr. 3461/21H, datë 27.10.2021) pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për akreditim të programit të studimit: Eficiencia e Energjisë, Master Profesional, 60 ECTS.

Në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë 15/2018 nuk është e paraparë ofrimi i programeve të studimit të nivelit Master Profesional.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që të refuzojë aprovimin e aplikacionit për programin e studimit Eficiencia e Energjisë, Master Profesional, 60 ECTS.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Pastaj, ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.

Prof. Ass. Dr. Hashim Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

